

Fjala e Paqes

Gjoni e pa Jezusin
duke ardhur kah ai
e tha: Ja, Qengji I Hyut!
Ky ia shlyen
mekatin botës!
(Gj 1,29)

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 1 (132) Viti XIX Dhjetor 2016-Janar 2017

PAPA FRANÇESKU: JO DHUNA, STIL I NJË POLITIKE PAQEJE NË DITËN E 50-TË BOTËRORE TË PAQES

JO DHUNA
stil i një politike paqeje
Papa Françesku

Vit të mbarë o Shkodër!

KONCERT FESTIV PËR PAQEN
9 janar 2017, Ora 18.00 Në Teatrin "Migjeni"

Në bashkëpunim me:
Bashkia Shkodër, Teatri "Migjeni", Komuniteti Sant'Egidio

Kushtet atmosferike të pafavorshme në ditët e para të muajit Janar nuk e kanë penguar Komisionin për Drejtësi dhe Paqe dhe Arqipeshkvinë Shkodër për të zhvilluar aktivitetin e përvitshëm kushtuar Ditës Botërore të Paqes. Këtë vit, më 09.01.2017, ora 17-19.30 Arqipeshkvia Shkodër dhe Komisioni Drejtësi dhe Paqe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Teatrin Migjeni dhe Komunitetin Sant'Egidio zhvilluan aktivitetin "Jo Dhuna: stil i një politike paqeje. Vit të mbarë o Shkodër" që i referohet mesazhit të Atit të Shenjtë Françesk për Ditën Botërore të Paqes.

Marshimi tradicional i paqes nisi nga Katedralja. Përgjegjësja Xhoana Marashi bëri të ditur për të gjithë ata që denjuan t'i bashkohen këtij marshimi (ndër ta klerikë, të rinj e të reja nga komuniteti, të rinjtë me aftësi ndryshe të Shoqatës "Projekti Shpresa", Instituti i Motrave të Nënë Terezës, Shoqata "Madonnina del Grappa" e të tjerë të interesuar) qëllimin i cili ka të bëjë me sensibilizimin e të gjithëve për të kuptuar se konfliktet nuk janë për njeriun dhe për t'i thënë jo terrorit që po ndodh në botë.

Arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra në nisje të këtij aktiviteti dha mesazhin e tij: "Marshimi që ne bëjmë ka disa vite e fillojmë këtu, vazhdojmë tek Instituti i Motrave Stigmatine dhe ndalemi tek Sheshi "Nënë Tereza" për të përfunduar tek Teatri Migjeni për të paraqitur mesazhin e paqes të Papa Françeskut. Këtë vit fatkeqësisht kemi parë që në ca vende ka luftë, me shumë krime me shumë atentate. Papa Françesku ka dhënë një mesazh: Jo dhuna, të jetë stili i secilit nëse ne dëshirojmë të kemi një botë më të re që viti në të cilin kemi hyrë të jetë vërtet i mbarë, duhet të heqim nga zemra secili prej nesh ato inate, urrejtje që të jemi punëtorë të paqes. Ky është urimi. Dhe nëse në çdo familje do të fillojmë me gje të vogla të dashurisë, të mirëkuptimit, respektit, durimit atëherë do të jetë ndryshe jeta personale, familjare dhe shoqërore".

Më pas ndalesa e parë u bë tek Motrat Stigmatine ku fjalën e mori Motër Dukate Radoja e cila vuri theksin se martirja stigmatine, Marije Tuci luftoi për paqen, i tha jo dhunës dhe sot shërben si një model.

Ndalesa e fundit u bë tek Sheshi Nënë Tereza, drejt të cilit të gjithë të rinjtë dhe klerikët me pankarta në duar marshuan duke shpërndarë mesazhe paqeje dhe dashurie. Imzot Massafra sërish mori fjalën duke theksuar: "Kjo ecje merr një tjetër kuptim dhe rëndësi, në një vit të mbushur me trazira dhe vrasje kudo në botë. Të kemi parasysh që të mos i përgjigjemi tjetrit me ngurtësi jo të keqes me të keqe."

Në mbyllje të kësaj ndalese, ndezi një flakë të shpresës për paqe për

t'i thënë jo luftës. Më pas ftoi Atë Nikolla Petani po ashtu për të ndezur flakën e shpresës duke e lëshuar në hapësirën e qytetit të Shkodrës me qëllim për të shpërndarë sa më shumë mesazhin e paqes. Ky marshim u mbyll me koncertin festiv për paqen në teatrin Migjeni me titull "Vit të Mbarë o Shkodër."

Në Teatrin Migjeni u shfaq një koncert mjaft domethënës i cili u drejtua nga gazetarët e moderatorët e mirënjohur, Simon dhe Eliona Shkreli dhe u realizua nga kujdesi i veçantë i Drejtorit të Drejtësi dhe Paqe, Luigj Mila dhe regjisorit, Aldo Nika. Në këtë koncert morën pjesë mjaft të rinj e të reja nga famulli të ndryshme, dhe të rinj e të reja të qytetit të Shkodrës, por edhe personat me aftësi ndryshe të Projektit Shpresa të cilët performuan "Yjet dhe Krijuesi i Universit" ku dhanë mesazhin e shpresës që duhet të ketë njeriu në jetë. Ndër të tjera u shfaq edhe një reportazh i shkurtër mbi veprimtarinë 20 vjeçare të Komisionit Drejtësi dhe Paqe.

Në mbyllje, fjala iu dha Imzot Massafra-s dhe atë Nikolla Petani të cilët bënë thirrje për më pak lufëtra dhe dhunë në botë, për më shumë humanizëm karshi të varfërve, të pambrojturve dhe personave me aftësi ndryshe.

Imzot Massafra theksoi: "Duhet që të kemi paqe në zemrat tona

Vijon në fq. 2



PAPA FRANÇESKU: JO DHUNA, STIL I NJË POLITIKE PAQEJE NË DITËN E 50-TË BOTËRORE TË PAQES

vijim i fq. 1

pikërisht ne Ati i Shenjtë na bën thirrje me këtë mesazh për paqen 2017, me siguri ai flet edhe për një politikë për paqen duke i nxitur institucionet që të bëjnë programe zhvillimi të mbështetura në veprime të drejtësisë shoqërore dhe të sigurojnë punë për çdo njeri, por kjo thirrje u drejtohet në mënyrë të vecantë ndërgjegjeve të individëve jo vetëm politikanëve dhe sheh familjen vendin ideal për të zhvilluar prirjen për jo dhunë”

Atë Nikolla Petani shprehu: “ Në qoftë se ne do i mësojmë fëmijët tanë me egërsinë, ata gjithmonë do të sillen egër jo vetëm kundër nesh, por edhe kundër botës. Le të depërtojmë në zemrat e secilit mesazhi i Papa Franceskut; le të angazhohemi vëllezër e motra; të angazhohemi do të thotë që ta duam më fort njëri tjetrin.. Le të jemi ne të rinjtë e të rejtat motrat vëllezërit dhe baballarët promotorët e paqes”.

Ndërsa në fjalën e saj Kryetarja e Bashkisë, Znj. Voltana Ademi iu referua dhe fjalës së Papa Franceskut duke thënë se sot më shumë se kurrë lind nevoja për të luftuar dhunën dhe për të qënë pranë atyre që kanë më shumë nevojë: “ Mesazhi i Papa Franceskut vjen në një kohë të

vështirë jo vetëm globale por edhe shqiptare.

Vëmendja e gjithsecilit prej nesh në ndërgjegjen e gjithsecilit prej nesh është jo vetëm jo dhunë por mirësi, paqe dhënie dore përkundrejt atij që ka më shumë nevojë e sigurisht pozitivitet, mirësi, buzëqeshje sikur thoshte Nënë Tereza për gjithsecilin të afërmin familjen fëmijën shokun shoqen, miqtë të rinjtë për më të vjetrit për ata që kanë nevojë për të gjithë shoqërinë tonë“.

I gjithë aktiviteti që u zhvillua në Teatrin Migjeni predikonte më shumë paqe në një kohë kur luftrat dhe dhuna janë shndërruar në një mjet kryesor kudo në botë.

Në mbyllje, bashkohemi me mesazhin e Papa Franceskut i cili i uron paqen çdo burri, gruaje, djali dhe vajze dhe që lutet derisa përngjasimi dhe shëmbëlltyra me Hyjin e çdo personi të na mundësojë që ta njohim njëri-tjetrin si dhurata të shenjta të pajisura me një dinjitet të pafund.Sidomos në situatë konflikti, e respektoshim këtë “dinjitet më të thellë” dhe e bëfshim jodhunën aktive stilin tonë të jetës.

Suela NDOJA



Prot. n. 51/2016
Tiranë, 02/12/2016

Lendë: Letër për kohën e Ardhjes dhe për “Vizita ad Limina”

Shumë të dashur meshtarë, rregulltarë, rregulltare
Shumë të dashur besimtarë të Dioqezave tona,

Zoti ju mbushtë me gëzim e shpresë dhe bëftë që secili prej jush ta pranojë praninë e tij si Atë i mirë dhe i dashur.

Sapo ka përfunduar Viti jubilar i Mëshirës gjatë të cilit Zoti është denjuar të derdhë shumë hire mbi ne: hiri i faljes dhe i shlyerjes së mëkateve e ndëshkimeve; hiri i Shenjtërimit të Nënë Terezës dhe ai i Lumnimit të Martirëve tanë; hiri i krijimit të një kardinali të Kishës sonë në personin e dom Ernest Simonit – Troshanit.

Çdo dhuratë që merret prej Zotit, megjithëse falas, kërkon nga ana jonë angazhimin që ta ruajmë dhe ta përdorim mirë atë. Kështu, hirit të faljes duhet t’i përgjigjet angazhimi ynë për të qënë të mëshirshëm në praktikimin e veprave të mëshirshme; atij të shenjtërimit dhe të lumnimit duhet t’i përgjigjet angazhimi ynë për të imituar virtytet e shenjtërve tanë; atij të krijimit të një Kardinali, angazhimi për të qënë gjithnjë e më të vëmendshëm e të kujdesshëm për të jetuar jetën e bashkësisë së krishterë dioqezane dhe famullitare.

Tani para nesh hapet një rrugë e re, e përruruar prej Ardhjes që sapo ka filluar: një vit i ri hiri në të cilin duhet ta jetojmë plotësisht jetën e fesë me guxim dhe me vullnetin për t’u dhënë të gjithëve dëshminë e asaj se sa gjë e bukur është të jesh i krishterë. Dhe që kjo të mund të realizohet Ati i Shenjtë Françesku ka publikuar Letrën Apostolike “Misericordia et Misera” me të cilën uron që të shohë një Kishë gjithnjë e më shumë në përputhje me zemrën e mëshirshme të Krishtit, sidomos në qëndrimet konkrete.

Kisha jonë që është në Shqipëri synon të jetë plotësisht në harmoni me Atin e Shenjtë dhe të marrë përsipër angazhime konkrete në këtë drejtim, ashtu si edhe në përshtatjen e strukturave të saj me orientimet papnore.

Për të arritur këtë qëllim do të jetë i nevojshëm para së gjithash një verifikim serioz i rrugëtimit të bërë në këta vitet e fundit; verifikim që po përgatitemi të bëjmë me ndihmën e bashkëpunëtorëve tanë dhe të atyre që kanë detyra zyrtare në dioqezat dhe arqidioqezat tona. Hapi i dytë do të jetë ai që të hartohen perspektivat për të ardhmen, si në termat e objektivave që duhen arritur ashtu edhe në termat e rishikimeve konkrete që duhen bërë.

Rezultati i kësaj pune do t’i dorëzohet Atit të Shenjtë në Vizitën e ardhshme “ad Limina” që ne, ipeshkvinitë e Shqipërisë, do të kemi në Romë më 29 maj deri më 2 qershor të vitit të ardhshëm.

Prandaj, u kërkoj të gjithëve dhe secilit që së bashku me ne të marrë përsipër këtë punë dhe, kështu, të jetë bashkëpërgjegjës në jetën e në administrimin e bashkësisë dioqezane. Ndihma që kërkojmë është ajo e lutjes drejtuar Shpirtit Shenjt që t’i ndriçojë këto punime dhe të na japë forcën e aftësinë të veprojmë për të mirën e kësaj Kise. Sugjerojmë që lutjes së përbashkët të Rruzares që do të bëhet para çdo Meshe të shenjtë t’i shtohet një “Ati Ynë”, një “Të falemi, Mari”, një “Lavdi” sipas këtij qëllim të vecantë dhe t’i kushtohen Zotit frytet e flijimeve të vogla e të mëdha personale që të gjithë ne mund të bëjmë.

Ju fjalënderojmë për angazhimin që do të keni në shoqërimin e këtij momenti kaq delikat dhe të rëndësishëm të Kishës sonë dhe, ndërsa ju urojmë të jetoni një kohë të frytshme të Ardhjes që t’ju bëjë të arrini në një kremtim të gëzueshëm të Krishtlindjes, ju bekojmë me gjithë zemër.

+ Kujdesi i paqes
+ I. Stajković
dan jua fjalë



Ipeshkvinitë tuaj

+ Kujdesi i paqes
+ George Zendej

NDËRRON JETË PROF. WILLY KAMSI

WILLY KAMSI, djali i Gjonit. Ky gjendej në Bari (Itali), prej vitit 1919, për arsye studimi dhe ku pastaj kishte qëndruar meqë ishte kundër Ahmet Zogut. Në Bari, Gjoni, u takua edhe me të mërguar të tjerë shqiptarë, që kishin ikur prej Shqipërisë për të shpëtuar prej Ahmet Zogut, i cili ishte rikthyer në



pushtet pas rrëzimit prej fronit gjashtë muaj më përpara. Ai qëndroi në Bari deri në qershor të vitit 1940, kur u rikthye në Shqipëri, ku qe, ndër të tjera, Këshilltar i Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Pra Ëilly lindi në Bari, më 17.12.1926, ku studioi derisa u kthye përfundimisht me familjen e vet në Shqipëri, në vitin 1943. Qe Përgjegjës i Bibliotekës së Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, aktualisht Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në vitin 1993, pas rënies së regjimit komunist, qe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë. Detyrë që e pati deri në vitin 1996, deri kur doli në pension. Qysh i ri iu kushtua studimeve historike. E famshme mbetet vepra e tij në katër vëllime e bibliografisë kronologjike të pesë revistave kulturore shqiptare: Shqipëri (Brusel-Londër: 1897-1909), Hylli i Dritës e Françeskanëve (Shkodër-Tiranë: 1913-1944), LEKA e Jezuitëve (Shkodër: 1929-1944), Shkëndija (Tiranë: 1940-1943), Shëjzat (Romë: 1957-1978). Veprimtaria e tij e gjatë dhe serioze kulturore ka bërë që të meritojë tituj të ndryshëm nderi në Shqipëri dhe Itali.

Vdiq në Shkodër më 24 janar 2017. Atij i takon merita për shumë përmbajtje dhe dëshmi në lidhje me Martirët Shqiptarë të Komunizmit. Kisha Shqiptare e kujton me mirënjohje dhe i drejton Zotit lutjen që shpirti i tij të pushojë në paqen e të drejtëve.

“KUJTOJUNI ORË E ÇAST SE JENI KËTU ME NJË MISION TË NALTË”
KARDINAL DOM ERNEST TROSHANI NË PARLAMENT

Asht një nder i veçantë sot për mue me folë prej kësaj foltoreje, dhe me ju drejtue ju, përfaqësuesve të popullit shqiptar. Ashtu sic asht një nder i pashoq me përfaqësue dhe me folë në emën të Kishës katolike shqiptare.

Nuk kam ardhë këtu me ju msue asgja të re, por kam ardh ma se parit me falenderue atdheun e të gjithë popullin pse mbas një rrebeshi prej gadi pesë dekadash që i shkaktoi vëjtje e mjerime Kishës katolike, ma në fund gjeti forcën e duhun shpirtnore me ua njohtë vlerat bijve e bijave të tija që për me ruejt lirinë e ndërgjegjes dhe lirinë e besimit nuk i ranë mohit Zotit dhe nuk e braktisën popullin e tij.

Jam i fundit dëshmitar i një brezi klerikësh katolikë që vëjten dhe u persekutuen. Tue më ba Kardinal, Papa Francesku nuk më nderoi mue por nderoi gjithë Kishën katolike shqiptare e mundësisht të gjithë popullin shqiptar.

Ne, kemi punue me të gjitha forcat për ngritjen morale dhe kulturele të shqiptarëve, e edhe atëherë kur s'kemi pasë mjete tjera, kemi gjetë fjalë ngushëlluese dhe s'i kemi lanë vetëm ma të vogjlit dhe ma të vorfnit. I kemi shërbye këtij populli dhe kemi dëshmue me gjakun tonë se i përkasim atij dhe nuk ligshtohena edhe në orën ma të vështirë. Ky popull ka nda kashatën e gojës me ne, na ka ndihmue aq sa ka mujtë dhe na ka qëndrue afër. .

Të dashtun vllazen e motra, Po ju them se ne si Kishë katolike do të jena si gjithmonë në parimin e bashkëpunimin me gjithë forcat politike dhe shoqnore që kanë me punue për zhvillimin dhe përparimin e Shqipnisë demokratike dhe sovrane.Do të mbështesim gjithmonë zhvillimin e kulturës së vërtetë dhe s'do të reshtim tue punue për me i përkit familjes së përbashkët europiane, vlerat ma të kullueta të së cilës kemi kontribue edhe ne me I formue ndër shekuj.

Jam këtu me ju kujtue përvujtërisht ju, përfaqësuesve të këtij populli:Kujtojuni orë e cast se jeni këtu me një mision të naltë, prandaj mos i harroni nevojat e popullit, mos e leni mbas dore asnji cast popullin



tuej, e mos lejoni që përplasjet tueja politike, edhe atëherë kur janë të arsyeshme, të kenë në qendër luftën për pushtet por vetëm problemet e popullit shqiptar.

Jemi një komb ku jetojnë vllaznisht besime të ndryshme fetare, të barabarta para ligjit e të gjitha me detyrën e shenjtë me i shërbye Zotit dhe idealeve tona kombëtare. Nuk due me folë për tolerancë por për vllaznim, që asht ma tepër.

Ta kultivojmë pra vllazninë ndërfetare, besimi i vërtetë në Zotin dhe liria na ndihmojnë me gjallnue ma fort vlerat e solidaritetit dhe të

ndihmës ndaj të gjithë atyne që shoqnia i ka lënë mënjane. Krishti, tue marrë shëmbëlltyrën njerëzore ka lindë në një votër të vorfën prej Marisë dhe shpirtit shenjt. Kujdesin ma të madh ai e ka pasë për të vobektit, për të sëmuret, për rata që vëjnë padrejtësisht dhe për rata që pendohen dhe duen me ndërrue rrjedhën e jetës së tyre. Mos ti lamë mas doret të gjitha këta, pse shkalla e qytetnisë së një kombi matet edhe prej kujdesit që ai tregon ndaj këtyre kategorive. Për ju un kam vetëm një porosi atnore: Krishti ka shtru parimin hyjnorë të pavdeksisë së

shpirtit: Cfarë të vlen o njeri? Po fitove edhe të gjitha pasuritë e botës në qoftëse humb shpirtin. Pra të përpiqemi ti shërbejmë me të gjitha forcat shërbimit hyjnor që të fitojm lumturinë e parrizit. Po hyjmë në vitin 2017 viti i triumfit të zemrës së papërlyer të Zojës së bekuar, nanës se Krishtit që na fton të lutemi për paqen, vëllazërim, dashuri e lumturi.

Ju të nderuar deputetë të përpiqeni që të gjithë së bashku, cdo njeri në Shqipëri duke shikuar në sytë tuaj të shohë begatinë, drejtësinë, bujarinë e bekimin hyjnor. Qëndroni më afër problemeve të popullit shqiptar, bani që politika të jetë shërbim dhe jo përfitim, e vetëm atëherë keni me pasë respektin e thellë të njerëzve të thjeshtë që kanë besuar tek ju. Zoti e bekoftë Shqipninë dhe shqiptarët, Zoti bekoftë familjet tueja.

Kardinal Dom Ernest Troshani

DRAMA “NATA E MARTIRIT” NË SKENËN E TEATRIT “MIGJENI”



Famullia Rranxa-Bushat realizoi një dramë mbi të Lumin Mark Çuni, Martirin që lindi në një ndër fshatrat e Famullisë sonë, më saktë në fshatin Rranxa. Të rinjtë që luajtën në këtë dramë sollën historinë, vuajtjet dhe padrejtësitë e bëra Markut, si dhe zemërmirësinë e besimin e patundushem të tij në Zotin.

Fillimisht qëllimi ishte që kjo dramë të vihej në skenë në fshatin tone, Rranxa, në ditën e festës së “Shën Rrokut”, më 16 gusht 2016, gjë që u arrit. Por kjo dramë mund të themi se i tejkaloi pritshmëritë tona, pasi arritëm ta shfaqnim edhe në skenën e teatrit “Migjeni” në Shkodër. Kjo po që do të quhej një ëndërr.

Të gjithë protagonistët e kësaj drame janë ndier plotësisht të nderuar që kanë shfaqur në skenë historinë e të Lumit Marku Çuni. Rikthimi në të shkuarën e errët të periudhës së komunizmit, secilin prej të rinjve që aktruan, e ka mbushur me frymën e përjetimit të ngjarjes dhe ata janë vendosur më së miri në rolet e tyre. Duhet theksuar përjetimi i protagonistit kryesor, Reald Rrotanit, në rolin e Mark Çunit, pasi ka shfaqur çdo vuajtje, çdo torturë, çdo fragment të asaj kohe dhe ka arritur të prekë të gjithë të pranishmit që kishin mbushur teatrin. E teatri ishte i mbushur nga persona që na bënë ta përjetonim edhe me më shumë përgjegjesi atë që na
Vijon në fq. 2

IMZOT ANGELO MASSAFRA OFM

20-vjetori i Shugurimit ipeshkvor

Çdo vit, me rastin e së kremtes së Dëftimit të Zotit, në Dioqezën tonë është perkujtuar përvjetori i Shugurimit ipeshkvor të Arqipeshkvit tonë. Aq më tepër këtë vit në të cilin mbushen 20 vjet, është dëshiruar që ky përvjetor të festohet në mënyrë edhe më kremtore, duke ia bërë të ditur gjithë Arkidioqezës dhe duke i ftuar të gjithë që të shtrëngohen përreth bariut tonë në kremtimin solemn të 6 janarit të kaluar në Katedrale.

Pikërisht kështu, në kremtimin në të cilin morën pjesë edhe i ngarkuari me punët e Nunciaturës apostolike, imzot Romanus..., Shkëlq. e Tij Arqipeshkvi i Tiranës, Imzot George Frendo, si dhe meshtarë e rregulltarë të shumtë, famullitari i Katedrales, në emër të të gjithë klerit dhe të popullit të Hyjit i shprehu Arqipeshkvit ndjenjat e vlerësimit dhe të mirënjohjes për shërbesën e tij apostolike në këtë Dioqezë dhe në Dioqeza të tjera të Shqipërisë ku ka shërbyer më parë.

Nga ana e tij, Arqipeshkvi në homeli dëshiroi të kujtojë fjalët e Shën Gjon Palit II kur e shuguroi, me të cilat ia besonte atë veprimit të Shpirtit Shenjt për shërbesën në këtë tokë. **D h u r a t ë , k j o , q ë** Arqipeshkvi dëshiroi ta shtrijë tek e gjithë bashkësia kishtarë me këto fjalë: “Edhe unë ju besoj ju dhe gjithë Arkidioqezën e Shkodër-Pultit fuqisë krijuese të Atit, veprës shpëtimtare të Birit dhe veprimit shenjtërues të Shpirtit Shenjt. Trinia e Shenjtë gjetë në secilin prej jush hapësirën dhe gatishmërinë e mjaftueshme për të vazhduar të veproni e të punoni për të mirën e kësaj Kishe dhe që kjo Kishë të jetë vendi i privilegjuar nëpërmjet të cilit Ai të mund të vazhdojë t'i dëftohet botës si Shëlbues dhe Shpërblyes”.

Ky kremtim qe etapa e dytë e përvjetorit të shugurimit. Në të vërtetë, më 3 janar Imzot Massafra kishte shkuar në Skuincano, në Itali, për të bashkëndarë me imzot Luigi Pezzuto-n, Nunc apostolik në Bosnje Hercegovinë, Mal të Zi dhe Montekarlo, të njëjtin kujtim, pasi të dy janë shuguruar në të njëjtën ditë.

Redaksia e Fjalës së Paqes i uron Arqipeshkvit Imzot Massafra që ta shohë të realizuar ëndrrën e tij, të shprehur në homelinë e 6 janarit, ëndrrën për një Kishë me të vërtetë Misionare, dinamike, të aftë të lexojë shenjat e kohëve, të guximshme, të varfër në mjete, por të pasur në virtyte, një Kishë, pra, që i përgjigjet plotësisht pritshmërive të Krishtit.

Homelia e Arqipeshkvit

Qoftë levduar Jezu Krishti!

Bëmë që të jehojë në këtë tempull lajmi i gëzueshëm i Pashkëve që në këtë ditë, në të cilën kujtojmë dëftimin e Zotit, Kisha është e lumtur të shpallë sepse është në marrëdhënie të ngushtë me Misterin e Mishërimit të Birit të Hyjit që e kemi kujtuar për Krishtlindje. Në të vërtetë, për Krishtlindje lajmërohet Shpëtimtari, për Pashkë realizohet shpëtimi; për Krishtlindje Hyji bëhet njëri prej nesh, për Pashkë ne bëhemi si Ai.

Dhe këtë shndërrim e kujtojmë në mënyrë sakramentale në Pagëzim, prej ujërave të të cilit të gjithë ne kemi rilindur në një jetë të re, sipas masës së Krishtit, të bërë të ngjashëm me Të: Ai, Biri i Hyjit, na bën ne bij të Hyjit; Prift, Mbret dhe Profet na bën ne një popull priftëror e mbretëror, të aftë t'ia shpallë profetikisht botës; Ai, krye, na bën ne trupin e vet dhe gjymtyrët e veta, për ta bërë të pranishëm në kohë dhe në hapësirë; Ai që është, që ishte dhe që vjen, Zotëria i kohës dhe i historisë, na bën misionarë të tij në mënyrë që e gjithë bota të besojë në Të.

Për këtë arsye sot e bekojmë atë ujë që do ta merrni në

shtëpitë tuaja: nuk është vetëm një traditë, dhe mos e dhashtë Zoti të jetë një gjest fatisjellës, por një shenjë e fesë, e pranisë dhe e bekimit të Zotit! Ai duhet të mund të na kujtojë se jemi shpëtuar prej Jezusit dhe se jeta jonë duhet t'i përgjigjet shpëtimit që kemi marrë, duke na përtërirë vazhdimisht në mënyrën e të menduarit dhe të të vepruarit, duke ua përshtatur atë mësimëve të Ungjillit.

Vetëm në këtë mënyrë do të jetë e mundur të na referohen edhe ne ato fjalë të Isaisë që i dëgjuam në leximin e parë, një tekst shumë poetik që nuk dëshiron absolutisht të jetë një vetëlavdërim i popullit hebraik, por një përshkrim i asaj se si Hyji synon t'i dëftohet botës pikërisht falë

popullit të vet. Ne e dimë se Hyji ka dashur t'i dëftohet botës në Jezu Krishtin dhe, nëpërmjet tij, t'i tërheqë tek vetja të gjithë popujt.

Shën Pali, në leximin e dytë, na ka thënë edhe se Shpirti ua ka zbuluar këtë vullnet të Atit apostujve dhe profetëve të Krishtit në mënyrë që ata ta bënin të mundur. Si? Pikërisht nëpërmjet predikimit dhe Pagëzimit, në mënyrë që të gjithë të kenë mundësinë të marrin pjesë në të njëjtin premtim të bërë çdo besimtari: shpëtimi.

Shumë të dashur, si anëtarë të Kishës, pra si të pagëzuar, sot jemi të ftuar ta ripërvetësojmë Pagëzimin tonë, ta jetojmë atë në plotësi dhe me gëzim për t'u thënë të gjithëve, me vetë jetën tonë, se

sa bukur është t'i përkasim Krishtit, sa e mrekullueshme është të jemi të falur e të shpëtuar. Me fjalë të tjera, sot Zoti ia beson përsëri secilit prej nesh mandatin misionar për ta shpallur Atë si i vetmi Shpëtimtar i botës. Kështu, të bindur prej dëshmisë sonë shumë vëllezër e motra të tjera, sikurse Mbretërit e Lindjes në tregimin ungjillor, do të ndjekin yllin e fesë sonë dhe do të arrijnë në takimin me Krishtin. Në të vërtetë, detyra jonë është t'i çojmë njerëzit drejt Krishtit, jo të zëmë vendin e Tij! Pra, dëshmia jonë le të jetë e mbushur me përvujtëri dhe e lirë prej çdo vetëreferencialiteti.

Si bari i juaji, ëndërroj një Kishë me të vërtetë misionare, (Të gjithë në mision – ka qenë nën titulli i letrës baritore e vitit 2002), që shkon në periferitë, si na thotë Papa Françesku: një Kishë dinamike, e bërë prej barinjsh dhe besimtarësh që së bashku pyesin veten se si mund ta mishërojnë ungjillin sot, se si mund ta rifuqizojnë praktikën fetare në ata që janë larg, se si mund ta shëmbin murin që është duke u ngritur gjithnjë e më shumë mes fesë dhe jetës.

Ëndërroj një Kishë të aftë të lexojë shenjat e kohëve, largpamëse sikurse qenë Martirët tanë të lumë, syçelur për ta dalluar të mirën në

Vijon në fq. 5



IMZOT ANGELO MASSAFRA

20-vjetori i Shugurimit ipeshkvor

vijim i fq. 4

mënyrë që ta nxisë dhe mundësisht ta shtojë atë; por të aftë edhe të dallojë mashtrimet e kurthet që fshihen pas konsumizmit bashkëkohor.

Ëndërroj një Kishë të guximshme, të aftë të dalë haptazi për të shkatërruar të keqen, para së gjithash brenda saj, dhe të bëhet mbrojtëse e të drejtave themelore njerëzore, duke paditur padrejtësitë dhe duke bashkëpunuar për të mirën e kombeve në të cilët jeton dhe vepron. Një Kishë që, sikurse Nënë Tereza e Kalkutës, të cilën që prej shtatorit të kaluar kemi nderin ta thërrasim si shenjte, të jetë e aftë të marrë përsipër varfëritë, pritshmëritë dhe instancat më të thella të njerëzimit që vuan për t'u ridhënë dinjitet të varfërve dhe të shtypurve.

Por ëndërroj edhe një Kishë më të gjallë: pra të lirë nga gjithçka që e ngadalëson ecjen: e varfër në mjete, por e pasur në virtyte; e varfër në lavdi njerëzore, por e pasur në lavdinë që vjen vetëm prej Hyjit; e varfër dhe e aftë të bashkëndajë gjendjen e të fundëve të shoqërisë; një pjesë e vogël e këtij populli shqiptar, por një zemër e madhe që na bën të shkëlqejmë prej mirësisë dhe shenjtërisë së jetës.

Sot është edhe 20-vjetori i shugurimit tim ipeshkvor. I kujtoj ende fjalët që shën Gjon Pali II më drejtoi gjatë atij riti: ai më pyeti nëse isha i dërguar në Shqipëri dhe më besoi Shpirtit Shenjt që veprimi im baritor të ishte i drejtuar prej Zotit. (me 6 janar 1997 Ipeshkëv në Rrëshen dhe Adm. Apostolik në Lezhë dhe më 28 tetor 1997, pas vdekjes së të ndjerit Imzot Frano Illia, si Administrator Apostolik në Shkodër dhe në Sapë).

Të dashur, i jam mirënjohës Zotit dhe shën Gjon Palit II që më kanë zgjedhur të kryej këtë shërbesë në Kishën e Shqipërisë.

Falenderoj Kard. Ivan Dias, atëhere Nunci Apostolik në Shqipëri, të gjithë bashkëpunëtorët e 4 dioqezave; falenderoj Meshtarët e mbijetuar pas komunizmit; meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare dhe misionarë laikë; falenderoj të gjithë Edukatorët dhe Profesorët e Seminarit dhe meshtarë të shuguruar nga viti 2000 deri më sot, brënda dhe jashtë Shqipërisë; diakonët dhe seminaristët.

Falenderoj të gjithë ju të pranishmit, që keni pranuar ftesën time...falenderoj edhe ata që për arsye të ndryshme nuk kanë patur

mundësi për të qenë këtu me ne sot...edhe nëse shpirtërisht janë të pranishëm...

Një falënderim të veçantë juve të dashur besimtarë, që jeni në katedrale dhe që na ndiqni me Mediat dhe me Radio Marinë...për mbestetjen dhe për lutjen: ju kërkoj që të vazhdoni të lutuni për mua.

Të dashur, si Papa Gjon Pali II më besoi Shpirtit Shenjt që veprimi im baritor të ishte i drejtuar prej Zotit. Kështu sot, është dëshirë e imja që ai besim i personit tim Shpirtit Shenjt të kalojë tek ju.

Edhe unë ju besoj juve dhe gjithë Arkidioqezën e

Shkodër-Pultit fuqisë krijuese të Atit, veprës shpëtimtare të Birit dhe veprimit shenjtëruar të Shpirtit Shenjt. Trinia e Shenjtë gjettë në secilin prej jush hapësirën dhe gatishmërinë e mjaftueshme që të vazhdoni të veproni për të mirën e kësaj Kise dhe që kjo Kishë të jetë vendi i privilegjuar nëpërmjet të cilit Ai të mund të vazhdojë t'i dëftohet botës si Shpëtimtar dhe Shëlbues.

Ndërmjetësoshin për ne në këtë vit të ri Martirët tanë të Lumë: Imzot Vinçenc Prennushi dhe 37 Shokët. Amen.



IMZOT MASSAFRA MES ARBËRESHËVE TË LUNGROS (KALABRI)

Më 15 dhjetor 2016 Imzot Massafra mbajti një Tërheqje Shpirtërore për klerin e Eparkisë së Lungros në Kalabri (Itali) që pati si temë përshpirtërinë e Martirëve të shekullit XX në Shqipëri.

Ftesa e Eparkut, Imzot Donato Oliveiro, i pranishëm në Lumnimin e Martirëve më 5 nëntor 2016, ishte e nxitur edhe prej pranisë mes Martirëve të të Lumit Papas Josif Papamihali që në ato zona ka kaluar muajt e parë të shërbesës së tij meshtarake, duke lënë një kujtim shumë të mirë të tij dhe një shembull të ndritshëm të jetës meshtarake.

Që një rast i volitshëm edhe për të vizituar familjen e dom Giuseppe Barbatit në Specano Albaneze ku takoi edhe nënën e tij. Atë ditë, më 13 dhjetor, festa e shën Luçisë, me kremtimin e Meshës së shenjtë në famullinë e fshatit, u përurua Grazhdi, siç është traditë. Dita e parë e vizitës përfundoi

në Rosano Kalabro pranë Kuries ipeshkvore, mysafir i Imzot Giuseppe Satriano-s.

Më 14 dhjetor, dita filloi me Meshën e shenjtë në ipeshkvi, së bashku me ipeshkvin e me motrat, dhe vazhdoi me vizitën në Muzeun Dioqezan

që mban brenda tij Codex Purpureo, një Kod të hershëm të zbukuruar të shek. V-VI.

Prej këtu zhvendosja në Kozenca, pranë Seminarit të Eparkisë, mysafir i Vikarit të Përgjithshëm, Papas Pietro Lanza dhe, në mbrëmje pranë Kuries së Eparkisë.

Së fundi, më 15 dhjetor, pas kremtimit në shqip të liturgjisë hyjnore të shën Gjon Gojartit, zhvendosja në Shën Eufemi ku Imzot Massafra mbajti Tërheqjen Shpirtërore për klerin.

Nga këtu Imzoti u nis për Lamecia Terme ku mori rrugën e kthimit për Tiranë.




U SHUGURUA DIAKON FRA KOLË MITRI

Me datën 28.12.2016 në Kishën e Shën Françeskut në realitetin françeskan dhe Shkodër u shugurua diakon Fr. Kolë Mitri që i përket Kustodjes Françeskane Zoja Nunciatë në Shqipëri e Mal të Zi.

Meshën e udhëhoqi Shkëlqesia e tij Imzot Angelo Massafra OFM, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër – Pultit, i cili me shtrirjen e duarve dhe lutjen e shugurimit e shuguroi diakon bashkëvëllain tonë Fr. Kolë Mitri.

Në këtë kremtim ishin të pranishëm Kustodi ynë Fr. Aurel Gjerkaj, Asistenti i Ministrit Gjeneral për Shqipërinë Fr. Lovro Gavran, pothuajse të gjithë fretërit e Kustodjes sonë dhe shumë meshtarë të tjerë të dioqezave të ndryshme në Shqipëri. Fr. Kolë Mitri ka lindur në Lotaj të Shalës (Dukagjin) me datën 02.04.1988 dhe ka ndjekur shkollën fillore në vendlindje.

Më pas ka ndjekur shkollën e mesme teknike pyjore “Kol Margjini” në qytetin e Shkodrës të cilën e ndërpreu për një periudhë kohe për t’u zhvendosur në Itali, ashtu si shumë moshatarë të tij, për të punuar atje. Nëpërmjet disa takimeve që bëjnë fretërit tanë në Shën Marinë e Engjëjve në Asizi, ai ra në kontakt me



përshpirtërinë tonë. Kështu kërkoi të hynte në Provincën tonë të Zojës Nunciatë dhe me të marrë këtë vendim u kthye në Shqipëri si dhe u vendos në Kuvendin e Zojës Ruzare, tek Arra e Madhe në Shkodër, duke rifilluar kështu edhe shkollën e mesme të cilën e kishte lënë përgjysëm. Këtë shkollë e përfundoi në qershor të vitit 2010.

Me datën 04.09.2010 u pranua në noviciat nga Fort i Nderuari Fr. Gazmend Tinaj dhe u dërgua në Baccanello të Bergamos, Itali, për të kryer këtë vit të noviciatit. Pastaj u kthye në Shkodër për të filluar studimet në Filozofi e Teologji dhe po ndjek vitin e fundit të këtyre studimeve. Me datën 17.09.2016 ka bërë Kushtet e përjetshme në Kustodjen tonë në Kishën e Shën Françeskut në Gjuhadol, Shkodër.

Menjëherë pas kushteve është caktuar në bashkësinë e fretërve në Kuvendin e Shna Ndout në Laç-Kurbin. Ne si bashkëvëllezër të tij falënderojmë Zotin për thirrjen e tij dhe lusim Zotin për thirrje të reja meshtarake e rregulltare në Kishën tone të pranishme në trojet tona shqiptare si dhe anembanë në botë.

Atë Landi Jaku

BASHKËSIA THIRRORE DIOQEZANE

Jemi në vitin e X që në dioqezën tonë është i pranishëm një realitet siç është bashkësia thirrrore dioqezane. Kjo bashkësi u krijua pikërisht në vitin 2007 me mbështetjen dhe përkushtimin e Arqipeshkvit tonë Imzot Angelo Massafra dhe të përgjegjësit të thirrjeve Dom Gjovalin Simoni të cilët pas mbylljes së seminarit të ulët në seminarin ndërdioqezan shikuan të nevojshme ekzistencën e një realiteti të tillë në dioqezën tonë. Në fakt qëllimi i ekzistencës së kësaj bashkësie është që të krijojë një ambient sa më të përshtatshëm që të rinjtë tanë të shqyrtojnë dhe të shoqërohen për të bërë zgjedhjen e duhur në jete. Me një fjalë të kuptojnë vullnetin e Zotit për jetën e tyre. Siç mund të shikohet ajo nuk funksionon si një seminar apo para-seminar por si një bashkësi që ju vjen në ndihmë të rinjve për të kuptuar diçka më shumë mbi të ardhmen e tyre.

Gjatë këtyre dhjetë viteve kjo bashkësi ka shoqëruar shumë e shumë të rinj në zgjedhjet e tyre jetësore. Disa prej tze kanë kaluar direkt në seminarin ndërdioqezan shqiptar ku pasi kanë kryer formimin e tyre janë shuguruar meshtarë dhe diakonë. Në fakt këto janë edhe frytet e para të kësaj bashkësie. Disa të tjerë vazhdojnë formimin e tyre në këtë institucion kishtar për t’u përgatitur për meshtari. Të tjerë pasi kanë bërë një farë ecjeje kanë kuptuar thirrjen e tyre dhe mbeten miq shumë të mirë të kësaj shtëpie.

Këtë vit në bashkësinë tonë janë tre kandidatë të cilët vijnë nga famulli të ndryshme të dioqezës sonë të cilët janë nën drejtimin formativ të Dom Gjovalin Simonit i cili është njëkohësisht Përgjegjës Thirrjesh në Dioqezën tonë si edhe Zv/Rektor i Seminarit. Po ashtu ai ndihmohet në këtë detyrë pra në lidhje me bashkësinë nga Diakoni i sapo shuguruar

Mark Pashkja. Përveç aktiviteteve që në një farë mënyre janë tradicionale brenda bashkësisë tonë siç janë lutja, momentet e ndryshme argëtuese, takimet e formimit apo edhe kurset e ndryshme shkollore, këtë vit jemi duke bërë edhe takime të ndryshme thirrrore në famullitë e ndryshme të dioqezës sonë. Famulli në të cilat pasi marrim pjesë në meshën shenjtë duke u lutur për thirrje, në të shumtën e rasteve bëjmë edhe takime me të rinjtë e këtyre famullive. Deri tani kemi qenë në famullitë: Rragam-Sheldi, Beltojë-Asht-Kosmaç, Velipojë, Dajç-Bregu i Bunës, Velipojë,

Rranxa-Bushat, Hot etj. Shembulli i Martirëve tanë ka qene gjithmonë objekt shembulli dhe frymëzimi për takimet tona.

Duke shpresuar që dëshmia dhe shembulli i Imzot Vinçenc Prennushit dhe 37 shokëve martirë të bëhet objekt frymëzimi për të rinjtë tanë i lutemi Zotit që të dërgojë sa më shumë punëtorë në vreshtin e vet.

Dom Mark Pashkja, Diakon



25 VJET MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE SHQIPËRIA DHE SELIA E SHENJTË

Roli i Kishës Katolike në jetën e vendit

I nderuar Zoti Ministër,
I nderuar Imzot Causero,
Eminencë Don Ernest Troshan,
I nderuar Mons. Romanus dhe të dashur Vellëzer në Episkopat,
Ministrat, Deputetë dhe Ambasadorë,
Autoritete Fetare,
Të nderuar pjesëmarrës,

Në emër të Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë përshëndes këtë Konferencë kremtuese me rastin e 25 vjetorit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë.

Mund të thuhet me padysim që fryma e kësaj marrëdhënie ka qenë shumë e mirë në këto vite. Por qëllimi im në këto rreshta është të përshkruaj në vija të trasha kontributin që Kisha Katolike, me barinjtë e saj, meshtarët, motrat dhe të gjithë vepruesit baritorë, është munduar të japë në këto vite për ringritjen shpirtërore, morale, shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Hapja e Shqipërisë dhe demokratizimi i saj dhe lirija fetare ishin lajmet e mëdha për të gjithë. Menjëherë ata meshtarë e motra, që i kishin mbijetuar komunizmit, nisën punën e tyre për t'u ardhur në ndihmë shpirtërore e materiale katolikëve dhe të gjithë atyre që kishin nevojë. Qysh në vitet e para, gjithashtu shumë misionarë e misionare të Kishës Katolike, shumë fondacione e shoqata, organizma bamirësie, u angazhuan duke iu përgjigjur ftesës së Shën Gjon Palit II për të ardhur në Shqipëri e për të ndihmuar popullin shqiptar.



Në ato vite të para jemi përgjigjur si kemi mundur dhe sa kemi mundur ndaj nevojave shpirtërore dhe materiale të popullit shqiptar, nëpërmjet ndihmave, ushqimeve, veshjeve, por edhe duke nisur veprën për rindërtimin e Kishave të shkatërruar nga komunizmi dhe e strukturave tjera shpirtërore, shoqërore, shëndetësore dhe arsimore.

Në çdo emergjencë në këto vite Kisha Katolike, nëpërmjet Karitasit, famullive, meshtarëve, motrave dhe vullnetareve ka dhënë ndihmesën e saj. Të gjithë kujtojmë vitin '97, viti i marrëzisë kombëtare – si e quaj unë - në të cilin pjesa më e madhe e misionarëve nuk u largua nga Shqipëria; lufta e Kosovës (mars 1999) e pa Kishën Katolike të angazhuar në vetën e parë për të pranuar, shtrehuar dhe ndihmuar të shpërngulurit. Në raste përmytjesh a fatkeqësish të tjera natyrore po ashtu Kisha katolike nuk u tërhoq në asnjë moment.



Përveç emergjencave, Kisha Katolike është munduar në këto vite të japë ndihmën e saj edhe nëpërmjet edukimit dhe institucioneve arsimore. Shkollat, nga çerdhet, kopshtet, filloret dhe nëntëvjeçarët, të mesmet deri te Universiteti, janë shprehje e dashurisë dhe angazhimit të Kishës Katolike për vendin tonë dhe formimin e brezave të ardhshëm; kujtoj edhe angazhimin për të sëmuret me ambulancat: Gjithçka që kemi bërë dhe e bëjmë edhe sot, ka bazën në parimin e subsidiaritetit.

Po ashtu të gjithë ne ipeshkëvijtë kemi besuar dhe besojmë se dialogu ekumenik dhe ndërftar duhet promovuar dhe nxitur sa më shumë. Jemi munduar ta bëjmë këtë gjë nëpërmjet takimit me njëri-tjetrin edhe pse të ndryshëm nga njëri-tjetri.

Gjithashtu nuk kanë munguar në shumë raste edhe bashkëpunimi ndërmjet Kishës dhe Shtetit me nisma të përbashkëta në ndihmë të personave në nevojë, për shkollat, për kthimin e pronave edhe pse në këtë të fundit mbetet ende punë për t'u bërë së bashku. Këtu kujtoj mundësinë për zhdoganimin falas të gjërave që vijnë në emër të Kishës dhe në veçanti dy marrëveshjet me Selinë e Shenjtë ne viti 2002 dhe 2008; dhe më lejoni të kujtoj edhe një herë se ende kemi problemet e pronave. Për këto e për problemet e tjera, ashtu sikurse parashikojnë edhe marrëveshjet e bëra, ne kemi kerkuar që të ngrihet një Komisioni ad hoc dypalësh: uroj që të ngrihet sa më shpejt ky Komisioni ad Hoc, si fryt i këtij 25 vjetori.

Kisha katolike në Shqipëri e ndjen në natyrën e saj të thellë angazhimin shoqëror, si rruga për t'u afruar me njerëzit, për t'i shërbyer çdo njeriu, të vetëdijshëm se kështu i shërbejmë Zotit, si ka punuar Shenjtja Nëna Tereza dhe si kanë punuar 38 Martirë që u shpallen të Lumë me 5 nëntor 2016.

Uroj që marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë të ndikojnë edhe në bashkëpunimin ndërmjet Kishës Katolike në Shqipëri dhe Shtetit Shqiptar, dhe si fryt i kësaj dite të kemi sa më shpejt Ambasadorin në Selinë e Shenjtë. Ne si ipeshkëvinj, bashkë me popullin që udhëheqim, ndjehemi pjesë e gjallë e këtij vendi dhe dëshirojmë të vazhdojmë të japim kontributin tonë në të mirë të vendit, si na kanë nxitur Papa Gjon Pali II dhe Papa Françesku në vizitën e tyre në Shqipëri. Faleminderit dhe Urime të gjithëve.

*Imzot Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë*

DRAMA “NATA E MARTIRIT” NË SKENËN E TEATRIT “MIGJENI”

vijim i fq. 3

ishte besuar: ishte Shkëlqesia e Tij, Imzot Angelo Massafra, shumë meshtarë, shumë më shumë Motra, shumë katekistë apo animatorë të famullive të ndryshme dhe besmtarë të tjera nga Shkodra e nga fshatrat përreth.

Unë, si një ndër protagonistet e kësaj drame, mund të them me plot gojë se ishte jo vetëm një ndër përvojat e mia më të bukura, por edhe më e rëndësishmja e më e ndiera. Isha në rolin e nënës së Martirit, isha në shtratin e vdekjes, ku po tregoja dhimbjen e një nëne për djalën dhe po

përshkruaja se si komunizmi e ka torturuar Markun, se si atij iu mor jeta dhe se si mund të imagjinohej çasti i takimit të nënës me të birin në lumturinë e Parajsës. E gjithë kjo përvojë e ky përjetim qe falë famullitarit tonë Dom Dritan Ndoci.

Faleminderit nga zemra edhe drejtuesve të teatrit si edhe të gjithë atyre që na kanë mbështetur e që kanë bërë të mundur që kjo dramë të shfaqej edhe në skenën e lavdishme të teatrit “Migjeni”.

Gertruda Rrotani

SIMPOZIUM NDËRFETAR “FAMILJA NË KËNDVËSHTRIMIN E KRISHTERË DHE ISLAM”

Ditën e mërkure me datën 18 janar 2017 është mbajtur takimi në Departamentin e Shkencave Islame në Kolegjin Universitar Beder në bashkëpunim me Akademinë Teologjike Ortodokse Durrës dhe në bashkëpunim me Institutin Filozofik-Teologjik Shkodër.

Takim i organizuar mes tri palëve në nivel Akademik mes tre shkollave Teologjike, me temë “Familja në këndvështrimin e Krishterë dhe Islam”. Edhe një herë në këtë takim është vënë në dukje harmonia që qëndron mes komuniteteve Fetare në Shqipëri. Tolerancë e karakterizuar prej dialogut dhe dëshirës për të arritur të mirën e shoqërisë Shqiptare.

Dialog i cili sot është më i nevojshëm se kurrë më parë. Ku përballë sfidave dhe vështirësive që bota sot na propozon, një shoqëri gjithmonë e më shumë e shekullarizuar dhe ateiste, është e nevojshme që të gjithë ne të jemi të bashkuar, për t'i dëshmuar asaj të vërtetën, dhe që ne të angazhohemi më shumë për paqen dhe drejtësinë në botë. Pas fjalës përshëndetëse e mbajtur nga Rektori i Universitetit Prof. Dr. Ferdinand Gjana, i cili pohoj që ky takim ka një rëndësi dhe një mision të vetin, sepse si besimi i Krishterë po ashtu edhe ai Islam kanë për mision të tyre mirëqenien e individit, mirëqenien e familjes dhe mirëqenien e shoqërisë. Dhe ai në mënyrë të veçantë falënderoi komunitetet për bashkëpunimin dhe hapjen e tyre për organizimin e këtij takimi, për të parë së bashku ato pika të cilat na bashkojnë ndërmjet nesh.

Menjëherë mbas Rektorit të Universitetit Beder e mori fjalën Atë Mario Imperatori Drejtor i Institutin Filozofik-Teologjik Shkodër, i cili trajtoi temën “Familja e Shenjtë e Nazaretit, ikonë e parisë së Zotit” Atë Mario theksoi që Kisha vetëm duke filluar nga viti 1980 është bërë e vetëdijshme mbi rëndësinë e shenjtërisë së jetës martesore e familjare. Të dëshmosh përparësinë e marrëdhënies me Zotin edhe në jetën martesore e familjare, është një formë martirizimi, e ndoshta sot më shumë se në të kaluarën. Pikërisht në këtë kontekst pohon Atë Mario merr kuptim referenca ndaj Familjes së shenjtë të Nazaretit. Ajo është e rëndësishme sepse në të është përparësia e Zotit, feja në Të ka qenë absolute, sipas veçantisë së misionit unik prej Hyjit të besuar kësaj familje, ndryshe prej tonave.

Ndërsa në fjalën e mbajtur nga pedagogu Thoma Çomeni i Akademisë Ortodokse Durrës, me temë “Familja dhe roli i gruas në të”. Ai pohoi që;

sa herë që flitet për familjen përfytyrimi dhe vëmendja të shkojnë direkt në imazhin se cila konsiderohet sot familje? Perceptimi i sotëm është se familja përbëhet nga prindërit dhe fëmijët, dhe kjo konsiderohet familje-bërthamë. Dy persona mbi të cilët themelohet sot familja janë burri dhe grua, dhe Shkrimi Shenjtë e thekson fort krijimin e dy personave, burrë

dhe grua, sipas ikonës dhe ngjashmërisë së Perëndisë, për të krijuar bërthamën e Familjes. Ky gurë i vendosur nga Shkrimi i Shenjtë është i rëndësishëm, pasi na jep dimensionin ontologjik (qenësor) të qenieve, por në të njëjtën kohë na jep kornizën e zhvillimit të marrëdhënieve bashkohore dhe familjare, gjithashtu ky varg i Shkrimit Shenjtë sheh se marrëdhënia burrë-grua ekziston realisht, kur secili prej tyre është person i barabartë.

Në fjalën e mbajtur nga Elton Karaj, Pedagog i Universitetit Bedër, ku theksoi që një ndër pikat e përbashkëta mes nesh është edhe ajo e familjes. Tema që trajtoi ishte “Familja në shembujt Profetik”. Ku shembulli dhe roli i Profetëve është i një rëndësie të veçantë për mbarëvajtjen e familjes. Ashtu sikurse shihet edhe në Kuran burri dhe grua janë dy gjysma që plotësojnë një pjesë të vetme, kështu që të mendosh njërin të ndarë prej tjetrit do të ishte e gabuar në kontekstin e familjes, njëri më lartë dhe tjetri më poshtë do të ishte një gabim fatal të mendohet.

Në formimin e familjes theksohet në Kuran që Zoti ka vendosur mes burrit dhe gruas dashurinë dhe mëshirën. Një ndër gjërat me rëndësi nga shembulli i Profetëve është edhe komunikimi mes prindërve dhe fëmijëve, sepse mungesa e komunikimit është vrasare në ditët e sotme. Në historinë e Noheut i cili ka një fëmijë që nuk beson, mos besimtarë, e fton atë vazhdimisht që të hipin në anije të shpëtoj prej mbytjes por ai nuk pranon që të vij, këtu del në pah dhembshuria e babait ndaj fëmijës së tij. Dhe së fundmi kam dëshirë që të falënderoj Hyjin për këtë mundësi që na ka dhuruar, për t'u takuar së bashku, dhe për të dialoguar ndërmjet nesh. Dhe një falënderim i përzemërt në emrin e Atë Marios, Drejtor i Instituti Filozofik- Teologjik Shkodër, shkon për stafin e Universitetit Beder të cilët na kanë mirëpritur dhe për bujarinë e tyre që na kanë dëshmuar gjatë këtij takimi. Zoti bëftë që kjo vëllazëri dhe ky bashkëpunim të rritet më shumë.

Kristjan Marku

DASHURIA E KRISHTIT NA SHTYN TË BASHKOHEMI

Është dashuria e sinqertë dhe e themeluar në personin e Krishtit ajo që nxit dhe shtynë njeriun drejt rimëkëmbjes personale e pastaj edhe drejt njësisë me bashkësinë në të cilën rritet dhe jeton. Me këtë shtysë u mbajt në Arqidioqezën Shkodër- Pult, java e lutjes për bashkimin e të krishterëve. Kjo nismë pat nisur thjesht si pasojë e dëshirës së disa të krishterëve të cilët kërkonin pajtimin mes të krishterëve dhe njësinë me anë të lutjes dialoguese dhe vepruese. Prandaj edhe Koncili II i Vatikanit në një ndër çështjet që shqyrtoi ishte dhe rimëkëmbja e njësisë dhe nxitja e sajë mes gjithë të Krishterëve pasi që Kisha është themeluar si një dhe e vetme prej Krishtit Zot (e folur qartë në dekretin mbi ekumenizmin “UNITATIS REDINTEGRATIO”).

Me datë 18 Janar 2017 në Kishën e Shën Kollit në Shkodër në praninë e besimtarëve u kremtua dita e lutjes për njësim mes të krishterëve nën temën: “Dashuria e Krishtit na shtyn të pajtohemi”, lutje e cila u drejtua prej shkëlqesisë së tij Imzot Angelo Massafra dhe famullitari i Kishës Ortodokse të Shkodrës Atë Nikolla Petani.

Vijon në fq. 10



KRISHTLINDJE NË MALËSITË E DIOQEZËS DHE NË SARANDË



Edhe këtë vit me gëzim të madh arritëm që të krishterët e fshatrave Dushman e Toplanë t'i bënim të përjetonin gëzimin e Fëmijës Hyjnor të lindur për ne. Me Atë Angelo De Padova OFM, Administrator Famullitar i Beltojës dhe Atë Piergiorgio OFM Kapuçin, më 23 dhjetor bashkëndamë gëzimin e Krishtlindjes me banorët e këtyre dy fshatrave që u mbledhën të shumtë për të përjetuar momentin e meshës së shenjtë dhe të dhuratës së hirit të pajtimit që i përgatiti ta jetonin me kthjelltësi takimin me Zotin.

Është gjithmonë gëzim të mund të përjetojmë momente të bashkëndarjes pas mundimit të ngjitjes, sepse e prekim me dorë faktin se Zoti bën rrugë vetë në zemrën e njerëzve dhe ne jemi e do të mbetemi mjete në duart e tij, mjete të paqes e të pranisë që dëshmon: nuk jeni vetëm!

Besimtarëve të Dushmanit e Toplanës që jetojnë shumë vështirësi për arsye të vetmisë si dhe të shfrytëzimit nga ata që nuk kanë skrupuj, u themi faleminderit që na mirëpritën përsëri. Me shpresën që të vazhdojnë të dinë të shohin Jezusin e varfër të



shtrirë në grazhd, falënderojmë Hyjin për gjërat e mëdha që bën në ata që strehohen në të.

Edhe në malet e Dukagjinit, në Breg Lum shkoi Famullitari dom Giuseppe Barbat, ndërsa në Pult shkoi bashkë me Motrat Françeskane të Krishtit Mbret dom Kledjan Vukaj, në datat 24 e 25 dhjetor.

Besimtarët e Komanit e kremtuan Krishtlindjen në orën 15.00 me meshën e kremtuar nga Atë Luigi Aluisi OFM.

Edhe këtë vit që e mundur të plotësohej kërkesa e Motrave të Sarandës për meshën e shenjtë të Krishtlindjes: falënderohet dom Gjovalin Suka që shkoi me shumë entuziazëm atje, më 24 dhe 25 dhjetor.

Lavdërojmë Zotin për gatishmërinë e meshtarëve që t'u shërbejnë atyre që janë larg dhe për kujdesin i Arqipeshkvit, i cili organizoi gjithçka.

Motër Gelsomina Rossi

NË LEZHË: 549 VJETORIT TË VDEKJES SË HEROIT TONË KOMBËTAR

Në përkujtim të 549 vjetorit të vdekjes së Heroit tone Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu, më datë 17 janar 2017 në orën 10.30, Bashkia Lezhë ju fton të merrni pjesë në ceremoninë përkujtimore që do të mbahet pranë vendvarrimit të Heroit tonë Kombëtar.

Me këtë rast, në orën 11.00 në Pallatin e Kulturës do të shfaqet edhe një aktivitet kulturor organizuar në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Gjergj Kastriot”. Faleminderit!

Fran Frrokaj- Kryetari i Bashkisë

DO TË ECIM PËRPARA ME NDIHMËN E ZOTIT

Një prej kremtimeve liturgjike është Festa e Fëmijëve të Pafajshëm të cilën Kisha Katolike si çdo vit e përkujton më 28 dhjetor. Kjo ditë na kujton vrasjen e fëmijëve të pafajshëm nga mbreti Herodi për zhdukjen e të gjithë fëmijëve që kishin moshën e Jezusit që kishte lindur.

Për këtë, Arqipeshkvi Metropolit Shkoder-Pult, Imzot.Imzot Angelo Massafra ka kremtuar ritualin e Meshës Shenjte në Kishën e Qendrës Bamirëse të Motrave të Nënë Terezës. Pjesë e kësaj Meshe të Shenjtë ishin të gjithë banorët e Institutit të Motrave të Nënë Terezës dhe kujdestarët, të rinjtë e të rejtat e Shoqatës “Projekti Shpresa” dhe të Shoqatës “Madonnina del Grappa” të shoqëruar nga kujdestarët socialë dhe nga stafi profesional. Po ashtu ishin të pranishëm të tjerë nga komuniteti.

Duke ju bashkuar mesazhit të kësaj dite, në fjalën e tij Imzot Massafra u kujdes që përveç falenderimit për angazhimin që kanë misionaret e “Shën Terezës”, të apelonte që jetët e fëmijëve të mbrohen, duke ju referuar rasteve të fundit në Alepo të Sirisë. Lutjet në këtë Meshë Shenjte i janë drejtuar pikërisht fëmijëve në situatë lufte; ata të cilët sot po vuajnë më shumë se askush tjetër në botë.

Gjatë fjalës së tij, ndër të tjera, Imzot. Massafra përcolli fjalën e lumturisë duke e lidhur me Festën e Krishtlindjeve: “Jezusi foshnje është buzëqeshja e Zotit për ne. Sot ne jemi të gjithë të lumtur e të qeshur sepse Zoti është me ne. Shën Pali thotë nëse Zoti është me ne, kush do të jetë kundër nesh? Askushsepse Zoti na bën që të jemi të fortë, edhe kur vuajmë do të kemi durim, edhe do t’u komunikojmë të tjerëve atë dashuri që na jep Zoti... Ky është urimi që ju bëj të gjithëve që edhe vështirësitë që mund të kemi t’i kalojmë, dikush nuk mund të ecë, dikush

nuk mund të kapërcejë, dikush nuk mund të këndojë por.... do të ecim përpara me ndihmën e Zotit”

Imzot Massafra duke folur për të gjithë të pranishmit përfshirë edhe për përfaqësuesit e mediave të qytetit të Shkodrës, bëri apel që 2017-ta të jetë një vit ku të gjithë të tregohemi më të dashur, më të hapur duke patur Jezusin në zemër dhe në mendje në çdo veprim që bëjmë duke iu larguar sfidave negative që errësojnë emocionet, ndjenjat dhe veprimet pozitive njerëzore.

Pas përfundimit të Meshës Shenjte, të gjithë patën kënaqësinë së bashku me të rinjtë e Shoqates "Madonnina del Grappa" të ndjekin një festë të veçantë të përgatitur nga vajzat e Institutit të Motrave të Nënë Terezës nën përkushtimin e edukatores Adriana

Marku. Në mbyllje të Festës, patën mundësinë që të gjithë, nën shijen e një koktejl, të shkëmbejnë çaste të bukura me njëri-tjetrin dhe të reflektojnë mbi mesazhin e Festës së Fëmijëve të Pafajshëm. Si çdo vit nuk munguan as dhuratat që u shpërndanë për Festat e Fundvitit të cilat ishin përgatitur nën kujdesin e misionareve të Nënë Terezës.

Së fundmi le të reflektojmë vërtetë se Jezusi fëmijë banon mes nesh duke na sjellë shpresën se të gjithë fëmijët në botë që kanë nevojë, që janë të sëmurë, që janë të braktisur, që janë në luftë ... do ta gjejnë dashurinë, mbrojtjen dhe shpëtimin që kërkojnë me ndihmën e Zotit.

*Suela NDOJA
Shoqata “Projekti Shpresa”*

DASHURIA E KRISHTIT NA SHTYN TË BASHKOHEMI

vijim i fq. 8

Me fjalën e rastit të mbajtur gjatë predikimit, Imzot Massafra vuri theksin mbi harmoninë fetare dhe nevojën e Kishave për bashkim, pasi kjo gjë bëhet dukë lënë pas krahëve të gjitha problemet e të shkuarës të cilat na larguan prej njëri-tjetrit me një prospektivë të re drejtë bashkimit. Duke shikuar Birin e Hyjit – theksoi Ai – secili prej nesh duhet të gjej në të dëshirën dhe nxitjen për pajtim pasi që vet ai i pari i cili duke vdekur në kryq na pajtoi me Atin dhe me njëri-tjetrin!

Po ashtu edhe Atë Nikolla vuri theksin mbi edukimin dhe formimin e brezave të rinj me frymën e pajtimit dhe me synim drejtë njësisë. Prej të dyve u shikua qartë dëshira e pastër e zemrës për të qenë një në Krishtin ashtu si edhe Ai është në Atin e në Shpirtin Shenjt.

Duke vazhduar sërish me vazhdën e lutjes për bashkimin e të Krishterëve, me datë 19 janar 2017 në kishën Ortodokse besimtarët e shumtë u mbledhën së bashku për të lutur Hyjin e bashkimit që të zgjojë

në zemrat e bijve të tij dëshirën për pajtim, nevojën për të harruar me falje e për të vazhduar të renë me forcën e njësisë ashtu siç donte vet Ai . Në mbarimin e kësaj lutje Atë Nikolla theksoi se sa i rëndësishëm është edukimi i fëmijëve me frymën e Krishtere, duke kujtuar historinë dhe

gabimet e së shkuarës në dritën e një të ardhmeje në të cilat ndreqen gabimet dhe shtohet bindja e dashjes së një Kise siç ka qenë në planin e Krishtit, një Kishë e Gjithmbarshme (Katolike), me një Bari të vetëm që është Krishti jo i ndarë.

Edhe Ipeshkvi ynë duke falënderuar të gjithë ata që morën pjesë në këto lutje, u la atyre porosinë që të jemi gjithmonë të gatshëm për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin, që të bëhemi një Kishë e vetme ashtu siç duhet të kishim qenë gjithmonë, të bashkuar për t'i shpallur botës shëlbimin që vjen prej Krishtit Zot.

*Fation Mullarhi -
Seminarist*




LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

LEKTORATI I ZEF MARKUT

Bashkësia famullitare e Shën Kollit në Vau-Dejës, e mbledhur së bashku në ditën e Zotit, në kremtimin e meshës së të dieles së XXV gjatë vitit, në Katedralen Shën Tereza e Kalkutës, gëzoi edhe në ceremoninë e marrjes së ministerit të Lektoratit të birit të kësaj famullie, seminaristit të Dioqezës së Sapës, Zef Marku.

“Do të kishte qenë bukur që sot mes nesh, të ishte bariu i Dioqezës i ndjeri Imzot Lucjani, për këtë shërbesë liturgjike, por jemi të sigurtë që Ai nga qielli gëzon dhe lutet me ne sot për hapat e parë të Zefit drejtë meshtarisë. Kështu e ka filluar fjalën e rastit d. Simon Kulli, Ad. Dioqezan e njëkohësisht famullitari i Katedrales. E ndërsa shtoi: jam sot me ju si Administrator dioqezan për t'i dhënë ministerin e Lektoratit, seminaristit të dioqezes sonë Zefit që ju e njihni mirë të gjithë.

Në ecjen e tij drejtë meshtarisë sot Kisha ia beson Fjalën e Zotit që ta studiojë dhe ta meditojë sa më shumë çdo ditë, dhe pas pak vitesh ta ushtrojë si meshtar me popullin e Zotit Fjalën e jetës. Le të jetë Fjala e Zotit dhe liturgia e kësaj të diele që



ne t'iu transmetosh te tereve

të na shëndrisë mendjen që ta vëmë në jetë sa më mirë këtë pasuri të madhe që ne kemi, dhe këtë moment që po jetojmë. I dashur Zef do të pyes ty dhe në një menyre secilin që është sot i pranishëm në këtë meshë : a nuk është kështu që Zoti është shfaqur në jetën tonë? Mendoj se çdo ditë e më shumë Ai është mes nesh e na ndihmon të realizojmë thirrjen tonë. Jezusi na kërkon që të degjohet. Dhe me degju do të thotë me ju bindur gjithçka që Ai na thotë. Ky është sekreti që ti Zef i dashur, duhet që ta jetosh dhe t'iu transmetosh të tjerëve në rrugën tënde”- përfundoi dom Simoni.

E kështu të gjithë së bashku lutën Hyjin Atë, që ta bekojë këtë të zgjedhur për shërbesën e leximeve, e në përmbushjen me besnikëri të shërbesës së tij ai të shpallin Krishtin dhe t'i japin lavdi Atit që është në qiell.

Zef Marku lindi në Vau-Dejës, me 17.10.1992 nga prindërit Frrok e Leze Marku. Studimet elementare dhe të mesme i kreu në vendlindje. Hyri në Seminar me 5 tetor të vitit 2011, ku prej 5 viteve vazhdon studimet e larta filozofike teologjike pranë Seminarit Ndërdioqezan në Shkodër.

MBYLLJA E VITIT TË MËSHIRËS NË SAPË

MËSHIRA ËSHTË RRUGA QË BASHKON ZOTIN ME NJERIUN

Të shtunën e Krishtit Mbret, kleri dioqezan i Sapës dhe mbarë besimtarët e kësaj dioqeze u bashkuan në Kishën Katedrale Shën Tereza e Kalkutës, në Vau-Dejës, për të kremtuar mbylljen e vitit Jubilar të Mëshirës, shpallur nga Papa Françesku, që nga 8 dhjetori i vitit të kaluar.

Ky rit i cili është kryer në të gjitha katedralet apo kishat e botës të shpallura si porta të mëshirës, edhe në portën e mëshirës së Sapës, u mbajt me celebrimin solemn dhe eukaristik të udhëhequr nga Administratori Dioqezan i Sapës, dom Simon Kulli, i cili, që në fillim të këtij kremtimi iu falenderua Zotit, Atit të Mëshirës që gjatë këtij viti i dhuroi gjithë njerëzimit mundësinë që ta sodisë fytyrën e tij të Mëshirshme.

“Mëshira është rruga që bashkon Zotin me njeriun”, kështu e titullonte letrën e tij baritore drejtuar dioqezës, ipeshkvi ynë i dashur, Imzot Lucjani. E pikërisht mbi këtë letër, dom Simoni kërkoi të kthente në memorien e të gjithëve porosinë e ipeshkvit, i cili dëshironte të nxiste besimtarët e vet ta sodisnin misterin e mëshirës, si burim gëzimi, qetësie, paqeje dhe kusht i domosdoshëm për Shëlbim.



Misteri i mëshirës është rruga që bashkon Zotin me njeriun thoshte ai, pasi ia hap zemrën shpresës se jemi gjithmonë të dashur pa marrë parasysh kufizimet, dobësitë dhe mëkatet tona.

Dom Simoni foli edhe mbi rrugëtimin shpirtëror që është jetuar gjatë këtij jubileu. E disa prej nismave që Zoti na ndihmoi t'i përjetojmë, ishin:

Ripërtëritja shpirtërore dhe ndarja e sakramentit të Rrëfimit, shoqëruar përmes Ndjesës së Plotë;

Katekeza, në çdo famulli ku vëmendje e veçantë u është kushtuar temave të mëshirës, faljes, pajtimit dhe dashurisë vëllazërore.

Falja dhe pajtimi i familjeve në konflikt që e kemi përjetuar me datën 2 prill në Dragushë, në Kishën kushtuar Mëshirës Hyjnore e shumë e shumë kremtime të tjera.

Kremtimi eukaristik vazhdoi me lutjet e përshtatshme drejtuar Hyjit të Gjithëpushtetshëm, duke i kënduar mëshirës së tij që përhapet nga breznia në brezni.


Violeta Marashi



25 Vjetori i Arqipeshkvit



Tiranë, Ministri e Jashtme



Rossano - Calabria



Lezhë, 17 Janar 2017



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Registrohu në kanalin tone!

Ngjarjet Kisha Katolike Shkoder Pult

Do të gësh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqesia
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë